



**Poliklinika Pleura**  
Dr. Shyqeri H. Hyseni



## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

**POLIKLINIKA PLEURA SH.P.K.** me seli në Ferizaj, Regjistrimi i Biznesit NUI 811505405, adresë rr. "Rexhep Bislimi" 70000 Ferizaj, e përfaqësuar nga z. Mumin Sh. Hyseni.

Dhe

**Sindikata e Policisë së Kosovës** në Prishtinë, Regjistrimi i Biznesit NUI 600595899, adresë rr. "Luan Haradinaj" p.n 10000 Prishtinë përfaqësuar nga Nënkryetari i Sindikatës së Policisë së Kosovës z. Avdi Hoti.

Lënda e marrëveshjes:

Kryerja e gjitha shërbimeve që Poliklinika Pleura ofron si: Pulmologji, Rdiologji, Ortopedi, Gastroenterologji, Laboratori dhe shërbimet e kujdesit primarë shëndetësor.

## **Neni 1**

### **Marrëveshja e përfitimeve**

Të gjithë anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe familjarët e tyre të ngushtë të përfitojnë 30% zbritje në shërbimet: vizita mjekësore adekuate, ekzaminimi i kërkuar nga mjeku adekuat, dhënia e terapisë së nevojshme, shpjegimi i diagnozës së cakuar si dhe këshillat për preventimin e sëmundjeve të parapara.

## **Neni 2**

### **Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi është të përshkruaj termat dhe kushtet në lidhje me marrëveshjen e përfitimeve midis Sindikatës së Policisë së Kosovës dhe Poliklinikës Pleura SH.P.K. për ofrimin e shërbimeve të lartcekura.

## **Neni 3**

### **Përkufizimet**

3.1 Programi i zbtijeve të shërbimeve të anëtarëve dhe familjarëve të tyre: i referohet marrëveshjes që u mundëson anëtarëve të Sindikatës së Policisë së Kosovës, të cilët do të përfitojnë zbritjen e caktuar në departamentet e caktuara në shërbimet e ofruara nga POLIKLINIKA PLEURA SH.P.K.

## **Neni 4**

### **Fushëveprimi**

4.1 Sindikata e Policisë së Kosovës njih vlerën dhe cilësinë e zbtijeve në shërbimet e ofruara nga Poliklinika Pleura SH.P.K.

4.2 Poliklinika Pleura SH.P.K. njih përfitimet e angazhimit me Sindikatën e Policisë së Kosovës duke ofruar zbritje për anëtarët dhe familjarët e ngushtë të anëtarëve të Sindikatës së Policisë së Kosovës.

## **Neni 5**

### **Përgjegjësit e palëve**

5.1 **Përgjegjësitë e Sindikatës së Policisë së Kosovës:**

- a. Sindikata e Policisë së Kosovës do të informoj anëtarët e saj për disponueshmërinë e Programit të marrëveshjes së anëtarëve, termat dhe kushtet që lidhen me të.
- b. Sindikata e Policisë së Kosovës do të inkurajojë anëtarët e saj që të përdorin shërbimet dhe të promovojnë ndërgjegjësimin për shërbimet e ofruara nga Poliklinika Pleura SH.P.K.

- c. Pagesa e shërbimeve të anëtarëve të Sindikatës së Policisë së Kosovës, të bëhet nga anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës menjëherë pas kryerjes së shërbimeve.

## 5.2 Përgjegjësitë e Poliklinika Pleura SH.P.K.

- a. Poliklinika Pleura SH.P.K. pranon të respektojë çmimet e ofruara siç specifikohet në këtë marrëveshje me Sindikatën e Policisë së Kosovës.
- b. Poliklinika Pleura SH.P.K. do ti ofrojë mbështjetjen dhe informacionin e nevojshëm Sindikatës së Policisë së Kosovës në lidhje me programin e shërbimeve.
- c. Poliklinika Pleura SH.P.K. do të trajtojë menjëherë çdo çështje ose shqetësim të ngritur nga anëtarët e Sindikatës së Policisë së Kosovës në lidhje me programin e shërbimit.

### Neni 6

#### Kohëzgjatja e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje fillon dhe është valide nga data e nënshkrimit.

Poliklinika Pleura

Përfaqësues z. Mumin Sh. Hyseni



Sindikata e Policisë së Kosovës

Nënkryetar z. Avdi Hoti

